



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/130
Datë: 22.02.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet: 121 dhe 123 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohet ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 122 dhe 124 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/130
Datë: 22.02.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Organizimin e Tregut për Produktet Bujqësore.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/130
Datë: 22.02.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 1,680,000.00 € (një milion e gjashtëqindetëdhjetë mijë euro) në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal me kod 221, nënprogrami Administrata Qendrore me kod 11321, nga kategoria e shpenzimeve kapitale, konkretisht nga Projekti "Programi për Zhvillim Rajonal" me kod 18782 në 14 (katërmbëdhjetë) projekte kapitale në përputhje me Marrëveshjet e Mirëkuptimit për projektet kapitale të nënshkruara nga Ministri i MZHR-së dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi rialokohen nga Projekti "Programi për Zhvillim Rajonal" me kod 18782 në këto projekte, me shumat e cekura si në vijim:
 - 2.1. "Rregullimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësorë, biçiklistë në Parkun e Kamenicës" - Komuna e Drenasit në shumë prej 120,000.00 €;
 - 2.2. "Kompleksi rekreativ në Çabrat" - Komuna e Gjakovës në shumë prej 140,000.00 €;
 - 2.3. "Kult Qendra"- Komuna e Gjilanit në shumë prej 120,000.00 €;
 - 2.4. "Qendra edukative dhe rekreative"-Komuna e Graçanicës në shumë prej 140,000.00 €;
 - 2.5. "Ndërtimi i urës që lidhë Komunën e Junikut me Eko fshatrat Gjocaj dhe Jasiq" - Komuna e Junikut në shumë prej 70,000.00 €;
 - 2.6. "Ndërtimi i ndriçimit rrugor në fshatin Verboc dhe Mogille"- Komuna e Kllokotit në shumë prej 60,000.00 €;
 - 2.7. "Rehabilitimi i infrastrukturës në zonën e qendrës kulturore historike në fshatin Janjevë" - Komuna e Lipjanit në shumë prej 120,000.00 €;
 - 2.8. "Ndërtimi i Parkut Mirusha" - Komuna e Malishevës në shumë prej 120,000.00 €;
 - 2.9. "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Mamushë - Opterush"-Komuna e Mamushës në shumë prej 140,000.00 €;
 - 2.10. "Ballkoni panoramik i qytetit dhe shtegu i ecjes - Komuna e Mitrovicës së Jugut" në shumë prej 120,000.00 €;
 - 2.11. "Ndërtimi i infrastrukturës për çiklizëm - Komuna e Ranillugut" në shumë prej 50,000.00 €;
 - 2.12. "Rregullimi i shtratit të lumit Klina me fshatrat Klinë e Poshtme - Kuqicë"- Komuna e Skenderajt në shumë prej 140,000.00 €;
 - 2.13. "Ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë me ndriçim në Komunën e Parteshit"-Komuna e Parteshit në shumë prej 70,000.00 €, në kodin e projektit kodit 16022;

- 2.14. "Ndërtimi i stacionit të autobusëve"- Komuna e Podujevës në shumë prej 270,000.00 €, në kodin e projektit 16013.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

In dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/130
Datë: 22.02.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Zyrës së Kryeministrit për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënie e autorizimit Zëvendëskryeministrit të parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, z. Besnik Bislimi, për nënshkrimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2022 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Kërkohet nga Presidentja e Republikës së Kosovës që autorizimi për nënshkrimin e Marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij Vendimi të jepet në përputhje me dispozitat dhe afatin e përcaktuar në nenin 7. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/130
Datë: 22.02.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Faturat e Kulturave Bujqësore dhe Fletëmagazinat.
2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/130
Datë: 22.02.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 24 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Pushat e Përgjegjësish Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 dhe nenin 51 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohen strukturat për hartimin e Strategjisë Shtetërore dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit.
2. Strukturat, nga pika 1. e këtij Vendimi, përbëhen nga Komisioni Ministror, Koordinatorin dhe Grupin Punues.
3. Komisioni Ministror themelohet në këtë përbërje:
 - 3.1. Z. Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve, kryesues;
 - 3.2. Znj. Albulena Haxhiu, Ministre e Drejtësisë;
 - 3.3. Z. Xhelal Sveçla, Ministër i Punëve të Brendshme;
 - 3.4. Znj. Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë.
4. Komisioni nga pika 3. e këtij Vendimi, është përgjegjës për:
 - Rishikimin e materialeve të përgatitura nga Grupin Punues;
 - Analizën e raporteve dhe rekomandimeve të përgatitura nga Grupin Punues;
 - Shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi rekomandimet e propozuara nga Grupin Punues apo Koordinatorin;
 - Hartimin e raportit me rekomandime për Qeverinë mbi formën finale të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.
5. Komisioni Ministror mund të kërkojë në çdo kohë raportime të nevojshme nga udhëheqësi i Grupit Punues drejtpërdrejtë apo përmes Koordinatorit.
6. Koordinatorin është përgjegjës për:
 - Pjesëmarrje të rregullt në Grupin Punues;
 - Mbikëqyrjen e punës së Grupit Punues;
 - Përgatitjen e raporteve të nevojshme për komisionin Ministror lidhur me punën e Grupit Punues;

- Koordinimin me ekspertë dhe partnerë me aprovim të Komisionit Ministror;
 - Pjesëmarrje në takimet e Komisionit Ministror.
7. Koordinator për procesin e hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit caktohet znj. Tea Blakaj-Hoxha, Këshilltare e Jashtme e Kryeministrit për Çështjet Ligjore.
 8. Grupi punues për hartimin e Strategjisë, përbëhet nga:
 - 8.1. Zyra për Planifikim Strategjik në Zyrë të Kryeministrit, kryesues;
 - 8.2. Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 8.3. Ministria e Drejtësisë, anëtar;
 - 8.4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
 - 8.5. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - 8.6. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar;
 - 8.7. Ministria e Ekonomisë, anëtar;
 - 8.8. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, anëtar;
 - 8.9. Ministria e Shëndetësisë, anëtar;
 - 8.10. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar.
 9. Si pjesë përbërëse e Grupit Punues ftohen edhe përfaqësuesit e Zyrës së Presidentes, Kuvendit të Republikës së Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Agjencisë Kundër Korrupsionit, Organit Shqyrtues të Prokurimit, Zyrës Kombëtare të Auditimit, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ndërmarrjet publike, agjenci të pavarura dhe institucionet tjera sipas nevojës.
 10. Institucionet, nga pika 8. dhe 9. e këtij Vendimi, propozimet e tyre për anëtarët e Grupit Punues, ia dërgojnë Komisionit Ministror përmes Koordinatorit.
 11. Grupi Punues mund të themelojë nëngrupe të veçanta mbi trajtimin e temave të caktuara, në koordinim me Koordinatorin, me aprovim të Komisionit Ministror.
 12. Sipas nevojave të punës së Grupit Punues, Kryesuesi në koordinim me Koordinatorin, mund të ftojë edhe përfaqësues tjerë të institucioneve publike, ekspertë të fushës, partnerët ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile.
 13. Grupi Punues ka përgjegjësitë të hartojë Strategjinë dhe Planin e Veprimit deri me 1 dhjetor 2023.
 14. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/130
Datë: 22.02.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 dhe nenin 51 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Ministror për zbatimin e Kartës për Komunën e Gjelbër dhe të Qëndrueshme në këtë përbërje:
 - 1.1. Z. Elbert Krasniqi, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, kryesues;
 - 1.2. Z. Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - 1.3. Z. Faton Peci, Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
 - 1.4. Znj. Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë, anëtare;
 - 1.5. Z. Liburn Aliu, Ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, anëtar;
 - 1.6. Znj. Rozeta Hajdari, Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, anëtare dhe
 - 1.7. Z. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë, anëtar.
2. Komisioni, nga pika 1. e këtij Vendimi është përgjegjës për koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve qendrore me ato lokale për zbatimin e Kartës për Komunën e Gjelbër dhe të Qëndrueshme, me qëllim të implementimit të zotimeve në kuadër të Agjendës së Gjelbër Evropiane, saktësisht zotimeve në:
 - 2.1. Fushën e energjisë, mobilitetit dhe dekarbonizimit;
 - 2.2. Ekonomisë qarkore: mbeturinave, riciklimit, prodhimit të qëndrueshëm dhe përdorimit eficient të burimeve;
 - 2.3. Biodiversitetit dhe mbrojtjes së natyrës;
 - 2.4. Adresim të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës; dhe
 - 2.5. Bujqësisë së qëndrueshme.
3. Komisioni mbështetet nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë i Zyrës së Kryeministrit.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/130
Datë: 22.02.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 42 paragrafi 3, dhe 4. të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 14 të Rregullores Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Pushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Venera Çerkini emërohet Drejtore Ekzekutive në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Mandati i të emëruarës nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë katër (4) vite.
3. E emëruara nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësit e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/130
Datë: 22.02.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 49, të nenit 50 dhe të nenit 52 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 38 të Ligjit Nr. 08/L-099 për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, të nenit 24 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim kërkesa për huamarje deri në 20,000,000 € (njëzetë milionë euro) për "Trepça Sh. A.", subjekt i aprovimit nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, me qëllim investimin kapital në miniera dhe flotacione.
2. Obligohet Thesari që për huadhënien ndaj Ndërmarrjes Publike të bëjë transferet dhe regjistrimet e nevojshme në regjistrat kontabël në kuadër të Sistemit Informatik për Menaxhimin e Financave të Kosovës.
3. Mjetet e huadhënies sipas këtij Vendimi përdoren vetëm për qëllimin e miratuar dhe nuk janë subjekt i asnjë kufizimi, pretendimi dhe detyrimi nga palët e treta.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/130
Datë: 22.02.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 29, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/1-21, të nenit 14, paragrafi 2, të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve që të aprovojë transferet nga nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" në ndonjë nën-program tjetër në tabelën 3.1 dhe 4.1 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, për shumat individuale të kërkuara deri në vlerën prej 40,000 € (dyzet mijë euro).
2. Shuma e përgjithshme e autorizimit sipas pikës 1. të këtij Vendimi nuk mund të kalojë 20% (njëzetë për qind) të shumës së ndarë vjetore të nën-programit "Shpenzimet e Paparashikuara".
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/130
Datë: 22.02.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut me qëllim të punësimit në institucionet e Republikës së Kosovës në këtë përbërje:
 - 1.1. Elizabeth Katherine Gowing, Këshilltare e Jashtme e Kryeministrit për Çështjet e Komuniteteve, kryesuese;
 - 1.2. Arben Shamolli, MASHTI, anëtar; dhe
 - 1.3. Mimoza Jashari, MASHTI, anëtar.
2. Komisioni është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e rregullave të procedurës që përfshijnë por nuk kufizohen në: procedurën e aplikimit, caktimit të kriterëve dhe vlerësimit të tyre në qëllim të verifikimit të diplomave, sipas mandatit të Komisionit nga pika 1. e këtij Vendimi, të vlefshme jo më gjatë se gjashtë (6) muaj.
3. Komisioni ka mandat një (1) vjeçar.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë